



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 21.10.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **15.10.2021** të parashtruar nga Operatori Ekonomik **1. "Bajra N.P.T. dhe 2. Komtel Project Engineering SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me motokultivator te vegjel,motokultivator te mdhej,pllugje,frzeza dhe mbjellse misri"**, me Nr. të Prok: **632-21-3669-1-2-1**, nxjerr:

### V E N D I M

**1. Refuzohetn** si të pabazuara Kërkesa për ri-shqyrtim e datës **15.10.2021** të parashtruar nga Operatori Ekonomik **1. "Bajra N.P.T. dhe 2. Komtel Project Engineering SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me motokultivator te vegjel,motokultivator te mdhej,pllugje,frzeza dhe mbjellse misri"**, me Nr. të Prok: **632-21-3669-1-2-1**, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 11.10.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.

**2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë 11.10.2021;**

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

## A r s y e t i m

Me dt datës **15.10.2021** të parashtruar nga Operatori Ekonomik **1.“Bajra N.P.T. dhe 2. Komtel Project Engineering SH.P.K** kanë parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me motokultivator te vegjel,motokultivator te mdhej,pllugje,frzeza dhe mbjellse misri”** , me Nr. të Prok: **632-21-3669-1-2-1**.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 21.10.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

### I- Përgjigje Operatorit Ekonomik “Bajra N.P.T.:

1.Për sa i përket pretendimit tuaj, të parë Autoriteti kontraktues sqaron se:

Ju si Operator Ekonomik keni prezantuar fotografi me specifika te pajisjeve të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret e kërkuar në FDT,

<b>Operatori ekonomik duhet të ofrojë katalog apo broshure me fotografi nga prodhuesi për moto kultivator, freza, pllugje dhe mbjellëse misri e te cilat duhet te jenë nga i njëjti Brand</b>	<b>Katalogu apo broshura me fotografi nga prodhuesi</b>
---	---

prandaj bazuar në nenin 39 të RROUPP, sipas të cilit ne përputhje me nenin 69 të LPP-se:

Ne rast se “Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara” atëherë “Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm”

Gjithashtu në katalogun e prezantuar në ofertën tuaj, pajisjet janë krejtësisht të ndryshme nga ato që i keni prezantuar në kërkesën për rishqyrtim të dt.15.10.2021, dhe si të tilla nuk mund të merren parasysh sepse kjo konsiderohet ndërrim material Neni 39 paragrafi 39.2 i RROUPP:

39.2 Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet.

Nga sa u tha më lartë konsiderojmë që ky pretendim i juaji është i pabazuar;

2. Për pretendimin tuaj të dytë, sqarojmë se është e drejtë e Autoritetit kontraktues të verifikoj çdo dokument të prezantuar në ofertë e operatorëve ekonomik, prandaj konsiderojmë që edhe ky pretendim i juaji është i pabazuar;

3. Sa i përket pretendimit tuaj të tretë, se operatori ekonomik i propozuar për kontratë, ka prezantuar pajisje të prodhimit turk, Autoriteti kontraktues sqaron se pajisjet e ofruara nga operatori ekonomik i propozuar për kontratë, janë prodhime turke por me standard evropian dhe plotësojnë kërkesat e Autoriteti kontraktues në paramasë, prandaj pretendimi juaj lidhur me këtë pikë është i pabazuar.

## **II- Përgjigje Operatorit Ekonomik Komtel Project Engineering SH.P.K :**

1. Për sa i përket pretendimit tuaj të parë, Autoriteti kontraktues sqaron se: Ju si Operator Ekonomik keni prezantuar fotografi me specifika të pajisjeve të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret e kërkuar në FDT:

<b>Operatori ekonomik duhet të ofrojë katalog apo broshure me fotografi nga prodhuesi për moto kultivator, freza, pllugje dhe mbjellëse misri e të cilat duhet të jenë nga i njëjti Brand</b>	<b>Katalogu apo broshura me fotografi nga prodhuesi</b>
---	---

prandaj bazuar në nenin 39 të RROUPP, sipas të cilit ne përputhje me nenin 69 të LPP-se:

Ne rast se “Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara” atëherë “Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm”

konsiderojmë që ky pretendim i juaji është i pabazuar;

2. Sa i përket pretendimit tuaj të dytë, se operatori ekonomik i propozuar për kontratë, ka prezantuar pajisje të prodhimit turk, Autoriteti kontraktues sqaron se pajisjet e ofruara nga operatori ekonomik i propozuar për kontratë, janë prodhime turke por me standard evropian dhe plotësojnë kërkesat e Autoriteti kontraktues në paramasë, prandaj pretendimi juaj lidhur me këtë pikë është i pabazuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës